



**KUVENDI I SHQIPËRISË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
SHËRBIMI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

Lënda: Memo mbi kandidaturat për kryetar dhe anëtar të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Drejtuar: **Znj. Fatjona Dhimitri**
Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Për dijeni: **Z. Gramoz RUÇI**
Kryetar i Kuvendit

E nderuar znj.Kryetare,

Kuvendi i Shqipërisë ka publikuar në faqen zyrtare njoftimin për vakancat e krijuara për 3(tre) anëtar dhe kryetar të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Pas përfundimit të afatit të datës 10 shkurt ora 16.00, rezultoi se për kryetar të AMA-s, u paraqitën kandidaturat e mëposhtme:

KANDIDATURA PËR KRYETAR

Nr.	Emri Mbiemri
1.	Maklen Misha
2.	Edvin Kukunja
3.	Fatjon Hoxhalli
4.	Denis Dedej

Pas përfundimit të afatit të datës 10 shkurt ora 16.00, rezultoi se për anëtar të AMA-s, ishin paraqitur kandidaturat e mëposhtme:

KANDIDATURA PËR ANËTAR

Nr.	Emri Mbiemri	Shoqata propozuese
1.	Anduela Abazi	Aleanca Gjimore për Zhvillim
2.	Petrit Ruka	Forumi Shqiptar për media të Lira
3.	Elkjana Gjipali	Shoqata e Kineastëve të Rinj “Belmond”
4.	Demir Ciftja	Aid to the Balkans
5.	Eva Bica	Tjetër Vizion
6.	Jakin Marena	Forumi Shqiptar për media të Lira
7.	Ylli Pata	Forumi Shqiptar për media të Lira
8.	Eneida Cakoni	Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
9.	Mitro Cela	Forumi Shqiptar për media të Lira
10.	Asim Sula	SHDFKSHP

Nga ana e Shërbimit të Monitorimit janë dërguar për verifikim formularët përkatës të cdo kandidati pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe paralelisht është bërë edhe shqyrtimi i dosjeve të cdo kandidati.

Gjithashtu të gjithë kandidatët kanë paraqitur të plotësuar formularin mbi konfliktin e interesit.

Mbështetur në nenin 8, të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, AMA përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë.

Kandidat për t’u zgjedhur anëtar i AMA-s mund të jetë çdo person, i cili ka përvojë pune jo më pak se 10 vjet në fushat e:

- a) medias në përgjithësi;*
- b) transmetimeve audiovizive të shërbimit publik, tregtar ose jotregtar;*
- c) prodhimit të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive;*
- ç) teknologjive të medias;*
- d) ekonomisë, administrimit dhe rregullave të konkurrencës;*
- dh) çështjeve të zhvillimit të gjuhës shqipe;*
- e) çështjeve që lidhen me personat me aftësi të kufizuar e grupeve të tjera vulnerabël;*
- ë) artit, kulturës e muzikës;*
- f) drejtësisë, ligjit, administrimit publik;*
- g) shkencës, mjedisit dhe zhvillimit teknologjik;*
- gj) mbrojtjes së konsumatorit;*
- h) veprimtarive shoqërore, edukuese dhe zhvillimit të bashkësive lokale, publike e kombëtare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë audiovizive, siç përcaktohet në këtë ligj.*

Nga shqyrtimi i kandidatëve për Kryetar të AMA-s rezultoi:

Z. Maklen Misha

Është diplomuar në vitin 2006 pranë Universitetit të Utrecht-it në Holandë, për Gjuhë Letërsi dhe Kulturë Angleze si dhe Histori e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ka një eksperiencë të gjatë në fushën përkthimit, botimeve, projekteve si dhe në administratë. Më konkretisht:

- 25 mars 2003 – 31 dhjetor 2005 (2 vite e 9 muaj) kontraktues individual/përkthyes terreni pranë Kombeve të Bashkuara Holandë vërtetim nga Kombet e Bashkuara, Holandë
- 16 shkurt 2006 – 31 gusht 2007 (1 vit e 6 muaj) nëpunës për gjuhën pranë Kombeve të Bashkuara Holandë vërtetim nga Kombet e Bashkuara, Holandë.
- 10 dhjetor 2010 – 22 korrik 2011 (7 muaj), Këshilltar pranë kabinetit të Kryetarit Bashkia Tiranë vërtetim nga Bashkia Tiranë
- 9 janar 2014 – 8 shtator 2015 këshilltar i zv kryeministërit (1 vit e 8 muaj) vërtetim nga Këshilli i Ministrave
- 28 shtator 2015 – 1 nëntor 2018 (3 vite e 1 muaj) Këshilltar pranë kabinetit të Kryetarit Bashkia Tiranë vërtetim nga Bashkia Tiranë
- Nëntor 2018 – shkurt 2019 (3 muaj) ABKONS sh.p.k vërtetim nga Sigurimet Shoqërore
- Shkurt 2019 shkurt 2020 (1 vit) Këshilltar Kabineti i Ministrit të Mbrojtjes vërtetim nga Sigurimet Shoqërore (deri në shtator 2019)

Eksperiencia të tjera të cilat kanë vërtetim nga punëdhënësi

Shtator 2007 – janar 2008 Drejtor i Kërkimeve Instituti i Studimeve Ndërkombëtare vërtetim nga instituti i Studimeve Ndërkombëtare, nga viti 2008 e në vazhdim është angazhuar mbi bazë projektsh (lista e projekteve me vërtetim nga punëdhënësi)

Prill 2008 - vazhdim konsulent i jashtëm në Institutin e komunikimit dhe dialogut ku është angazhuar mbi bazë projektsh dhe ka bërë disa përkthime librash. (lista e projekteve dhe e përkthimeve me vërtetim nga punëdhënësi)

Janar 2011 – vazhdim konsulent i jashtëm në Institutin Shqiptar të medias

- **Në total: 8 vite e një muaj të plota, 2 vite e 9 muaj kontraktues individual si dhe eksperiencia të tjera të cilat kanë vërtetim nga punëdhënësi (të përmendura më lart)**

Z. Edvin Kukunja

Është diplomuar në gusht të vitit 2010 pranë Universitetit të Torinos, Itali, Master për juridik. Ka punuar si avokat, konsulent ligjor, koordinator projekti dhe aktualisht është këshilltar ligjor në Ministrinë e Drejtësisë. Më konkretisht:

14 tetor 2013 – 22 maj 2017 (3 vite e 7 muaj) këshilltar Ministria e Arsimit dhe Sportit vërtetim librezë pune

29 mars 2018 – vazhdim (afro 1 vit) Këshilltar i Ministrit, Ministria e Drejtësisë vërtetim librezë pune

Shtator 2001 – maj 2007 Asistent administrativ Rari Nantes Torino Itali (nuk ka dokument mbështetës)

Maj 2008 – shtator 2010 ka punuar part –time (në total 121 javë) pranë kompanisë Residence Lucani S.r.l Torino Itali (dokument mbështetës nga Instituti Kombëtar Italian i Sigurimeve Shoqërore në gjuhën italiane)

Shtator 2011 – shtator 2012 Res Publica laë firm Tirana (nuk ka dokument mbështetës)

Maj 2012 – shkurt 2018 Avokat pranë LFC Tirana (nuk ka dokument mbështetës)

- **Në total: 4 vite e 7 muaj dhe 121 javë part time**

Z. Fatjon Hoxhalli

Është diplomuar në vitin 2012 pranë Universitetit të Paviors, Itali, Master Shkencor në Drejtësi. Ka një eksperiencë afro 6 vjecare në administratën publike ku ndër të tjera ka punuar si këshilltar për komunikimin në disa institucione, aktualisht punon si Drejtor i Zhvillimit të Biznesit pranë IDRA Research & Consulting. Më konkretisht:

06 janar 2014 – 1 shkurt 2016 Agjencia Kombëtare e Turizmit (2 vite e 1 muaj) vërtetim librezë pune

1 shkurt 2016 – 26 maj 2017 këshilltar i zv kryeministrit (1 vit e 4 muaj) vërtetim librezë pune
25 shtator 2017 - 16 janar 2019 (1 vit e 4 muaj) këshilltar i Minsitrit (Ministria e Bujqësisë) vërtetim librezë pune

22 janar 2019 – 1 prill 2019 (2 muaj) këshilltar i Minsitrit (Ministria e Arsimit) vërtetim librezë pune

8 prill 2019 – vazhdim IDRA sh.p.k

Eksperiencia të tjera të cilat kanë vërtetim nga punëdhënësi

Shtator 2009 – dhjetor 2013 bashkëpunëtor i jashtëm në Qendra Agenda (vërtetim nga punëdhënësi)

- **Në total: afro 6 vite pune sipas librezës së punës, dhe 4 vite e 3 muaj bashkëpunëtor i jashtëm në Qendra Agenda (vërtetim nga punëdhënësi)**

Z. Denis Dedej

Është diplomuar në vitin 2016 pranë Universitetit të Tiranës, Dega Gazetari dhe Komunikim e më tej Master Shkencor në Marrëdhënie me Publikun. Ka punuar në fushën e gazetarisë dhe si specialist komunikimi. Më konkretisht.

16 qershor 2010 – 13 mars 2012 (1 vit e 9 muaj) Shekulli Media Group vërtetim librezë pune

24 janar 2014 - 14 janar 2016 (afro 2 vjet) Shërbimi Kombëtar i Punësimit vërtetim librezë pune

15 janar 2016 – vazhdim (4 vite) Bashkia Tiranë vërtetim librezë pune

Eksperiencia të tjera të cilat kanë vërtetim nga punëdhënësi

Prill 2007 – maj 2010 (3 vite) konsulent i jashtëm në gazetën “Koha Jone” (vërtetim nga punëdhënësi)

- Në total: afro 7 vite e 9 muaj punë sipas librezës së punës dhe 3 vite konsulent i jashtëm në gazetën “Koha Jonë” (vërtetim nga punëdhënësi)

Nga shqyrtimi i kandidatëve për anëtar të AMA-s rezultoi:

1. Z. Mitro Cela

Ka përfunduar Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tiranës, Ka një eksperiencë shumë të gjatë mbi 20 vjetare si gazetar, ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë etj. Aktualisht është në një moshë 72 vjetare.

Plotëson kriteret ligjore.

2. Z. Asim Sula

Ka përfunduar Institutin e Lartë Bujqësor Korçë, Ka punuar si agronom në periudhën 2001 deri 2003 më tej gjatë periudhës 2004 deri 2014 ka punuar si përgjegjës lokal i Qendrës së Shërbimit Bujqësor Elbasan, nga 2014 e në vazhdim Drejtor Ekzekutiv i shoqërisë It&Al SHBB Elbasan. Ka një eksperiencë shumë të gjatë por në fushën e agronomisë, bujqësisë dhe blegtorisë.

Plotëson kriterin ligjor të përvojës 10 vjeçare në punë, por kjo përvojë është kryesisht në fushën e agronomisë, bujqësisë dhe blegtorisë.

3. Z. Demir Ciftja

Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Që prej vitit 2012 ushtron aktivitet privat si Avokat. Nuk ka librezë pune është i vetëpunësuar.

Nuk plotëson kriterin ligjor të përvojës 10 vjeçare në punë edhe nëse e marrim të mirëqenë që prej vitit 2012 sic deklaroi në CV ka ushtruar profesionin e avokatit.

4. Znj. Eva Bica

Ka përfunduar në vitin 2010 Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Torinos “E drejta e Administratës Publike dhe e Organizatave Ndërkombëtare” si dhe Master Shkencor në Juridik. Sipas CV ka filluar punë si lektore në nëntor të vitit 2010. Ndërkohë sipas librezës së punës dhe CV nga 8 gusht 2013 – 21 tetor 2013 ka punuar pranë Bashkisë Elbasan më tej në librezë shënohet që ka filluar punë si Sekretare e Përgjithshme në Prefekturën Elbasan. Ka edhe eksperiencë të tjera por që nuk kanë asnjë dokument mbështetës.

Nuk plotëson kriterin ligjor të përvojës 10 vjeçare në punë nëse i referohemi librezës së punës, ndërkohë për eksperiencat e tjera të deklarura në CV nuk kanë asnjë dokument mbështetës.

5. Z. Ylli Pata

Ka përfunduar Fakultetin e Shkencave Sociale, Dega Histori Gjeografi, pranë Universitetit të Shkodrës. Sipas Librezës së Punës ka punuar si Teknik pranë PTT në Dibër nga 4 shtator 1990 – 16 tetor 1995, Drejtor Informacioni dhe Drejtor i Teknologjisë në ATSH nga 11 nëntori 2013 – 4 maj 2015, dhe nga 11 korrik 2018 – 27 qershor 2019 këshilltar pranë AKEP. Si dokument mbështetës ka paraqitur vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën nga korriku 2012 – qershor 2019 dhe në total nga llogaritjet dalin mbi 6 vite të siguruara.

Plotëson kriteret ligjore duke përfshirë periudhën që ka në librezën e punës dhe vërtetimin nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

6. Znj. Anduela Abazi

Është diplomuar në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë Letërsi, Sipas CV së saj ka një eksperiencë të gjatë (mbi 10 vjecare) si gazetare, producente dhe moderatore, menaxhere e marrëdhënieve me publikun, skenariste rregjisore etj. Për këto eksperiencë nuk ka librezë pune, por ka paraqitur tre vërtetime dy nga RTSH dhe një nga Fondacioni “Trojet Etnografike”.

Në vërtetimet nga RTSH përmendet fakti se prej vitit 2019 e në vijim ka realizuar pranë RTSH projektin artistik televiziv “Kohë të Tjera”, ndërkohë që periudhat 1994 - 1998 ka punuar si gazetare e jashtme pranë RTSH, 2012 – 2015 ka realizuar si skenariste dhe rregjisore 12 dokumenarë “Udhëtime me Shije” pranë RTSH dhe në vitet 2015 – 2017 ka realizuar si skenariste dhe rregjisore emisionin “Ftesë për Rrëfim” pranë RTSH. Gjithashtu në vërtetimin nga Fondacioni “Trojet Etnografike” deklarohet se Znj. Abazi ka punuar si Menaxhere e Marrëdhënieve me Publikun në vitet 2013-2014 dhe 2003-2010.

Plotëson kriterin ligjor të përvojës 10 vjeçare në punë, por kjo përvojë vërtetohet vetëm përmes vërtetimeve nga RTSH dhe nga Fondacioni “Trojet Etnografike” dhe jo me librezë pune.

7. Z. Petrit Ruka

Ka përfunduar Institutin e Lartë Pedagogjik, dega Gjuhë Letërsi, në Shkodër. Ka një përvojë pune mbi 10 vjecare si rregjizor dhe skenarist, ka marrë titullin “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti i Republikës, për krijimtarinë e tij letrare dhe kinematografike si poet skenarist shkrimtar e publicist i shquar. Aktualisht është në një moshë 66 vjecare.

Plotëson kriteret ligjore.

8. Znj. Elkjana Gjipali

Ka përfunduar Akademinë e Arteve në Tiranë, për Regji filmi dhe Televizioni, në periudhën 2006-2011. Ka paraqitur Librezë të sigurime shëndetësore për periudhën nëntor 2014 – nëntor 2018. Vërtetim nga Shoqata e Kineastëve të Rinj “Belmond” që ka punuar pranë kësaj shoqate si producente e festivalit ndërkombëtar të filmit në vitet 2008 – 2014. Ndërkohë sipas CV së saj deklaroi se ka punuar si producente pranë Kinostudio Dardan dhe EJP Proction, gjithashtu ka punuar si këshilltare pranë Ministrisë së Kulturës dhe pedagoge pranë Universitetit “Aleksander Moisiu” Durrës por nuk ka dokumenta mbështetës.

Përvoja e punës nuk del e qartë pasi ka paraqitur vërtetime nga punëdhënësi dhe jo me librezë pune.

9. Z. Jakin Marena

Ka përfunduar Universitetin e Shkodrës, Dega Biologji Kimise. Përmes librezës së punës rezulton se ka një eksperiencë të gjatë mbi 10 vjecare në gazetari, mësimdhënie, etj.

Plotëson kriteret ligjore.

10. Znj. Eneida Cakoni

Ka përfunduar Fakultetin e Shkencave Sociale, Dega Punë Sociale, pranë Universitetit të Tiranës. I mungon librezë e punës. Në CV e saj ka deklaruar se nga viti 2004 deri në 2011 ka punuar pranë Ministrisë së Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në CV e saj ka deklaruar se nga viti 2015-2017 ka punuar si Drejtore Programi në organizatën “Together for Life” dhe nga viti 2000 – 2003 si Koordinatorë Projekti në Fakultetin e mjekësisë. Ka paraqitur kopjen e një kontrate pune afro 1 vjecare me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Nga janari 2018 punon si Menaxhere Programi pranë “Qendrës për të drejtat në Punë” CLR, (vërtetim nga punëdhënësi).

Përvoja e punës nuk del e qartë pasi ka paraqitur vërtetime nga punëdhënësi dhe jo me librezë pune.

Procedura vijon në zbatim të nenit 9, pika 4 të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili thotë:

“Për përzgjedhjen e kandidatëve alternative për çdo vend anëtar të AMA-s, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

a) shqyrton të gjitha kandidatë e paraqitura nga subjektet propozuese;

b) kandidatë e administruara, në bazë të propozimeve të mësipërme, i nënshtrohen përjashtimit një nga një. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.

Në çdo rast komisioni mban parasysh ruajtjen e balancës, tre kandidatë të mbështetur nga shumica parlamentare, tre të mbështetur nga opozita. Kandidatët për anëtarë të AMA-s i propozohen për miratim seancës plenare.

Përjashtimi i çdo kandidature duhet të argumentohet duke garantuar respektimin e parimit të moscenimit të integritetit personal dhe profesional të kandidatëve.”

SEKRETARI I PËRERGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ

Punoi: Marlind Myftiu

Këshilltar

Miratoi: Alkida Llakaj

Drejtor i Shërbimit të Monitorimit